

VENDIM
Nr. 516, datë 30.7.2014

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA “ALBA FILM”, SHA-JA, TE
MINISTRIA E KULTURËS, TË PASURISË “GODINA 4-KATËSHE, MAGAZINA E
KOSTUMOGRAFISË”, NË ISH-KINOSTUDIO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga “Alba Film”, sh.a.-ja, te Ministria e Kulturës, të pasurisë “Godina 4-katëshe, magazina e kostumografisë”, në ish-Kinostudio, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



